


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkivi - Archive - Archivio

Mr. Prof. No. 0697/2022
 Data/Batum: 22.11.2022

PRISHTINEJA



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkivi - Archive - Archivio

Mr. Prof. No. 1057/2022
 Data/Batum: 22.11.2022

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera/

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Odeljenje Budzeta- Budget Department

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Z. Naim Shala, Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Punëve të Brendshme			
CC:		Znj. Fahrije Tërnavaj, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Punëve të Brendshme			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve,			
NGA/OD/FROM:		Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projekt ligjit për zyrtarët publik			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	MF, Ndërtesa e Qeverisë	Data:	22.11.2022
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuar Z. Shala,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projekt ligjin për zyrtarët publik, formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Punëve të Brendshme, obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKT LIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitive, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Ministria e Punëve të Brendshme si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projekt ligji, përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se zbatimi i këtij projekt ligji do të krijoj kosto shtesë buxhetore për vitin 2025.

Ky projektligj propozohet nga Ministrinë e Punëve të Brendshme, konkretisht Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publik), ndërsa dispozitat e tij do të zbatohet në praktik nga të gjithë Organizatat Buxhetore të cilat janë të obliguara ta zbatojnë këtë projektligj.

Ministria e Punëve të Brendshme –Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publik) i cili do ta monitoroj zbatimin e këtij projektligji ka ndarje buxhetore të parapara në Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 në shumë prej € 819,475 të shpërndara nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve si vijon:

Vitet	2023	2024	2025
Paga dhe Shtesat	167,866	170,293	171,144
Mallrat dhe shërbimet	102,136	102,136	105,900
Gjithsejtë	€270,002	€272,429	€277,044

Aktivitete të cilat dalin nga ky projektligj që do të zbatohen nga Ministria e Punëve të Brendshme –Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publik) janë:

- Hartimi, propozimi, koordinimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave për zyrtaren/in publik, monitorimin dhe zbatimin e politikave për paga për zyrtaret/ët, funksionaret publik, planifikon, vendos, kryen sistemimin e nëpunëseve/ëve civil, të cilat/ët kanë përfunduar mandatin në pajtim me këtë projektligj.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e Sistemin të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, etj.

III- PERFUNDIM

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit shpreh opinionin e vet të pavarur dhe vlerëson se neni 67 i projektligjit për zyrtaret publik, konkretisht aktet nënligjore që do të rrjedhin nga ky nen mund të krijoj kosto shtesë buxhetore për vitin 2025. Të gjitha Organizatat Buxhetore të cilat janë të obliguara ta zbatojnë projekt ligjin për zyrtaret publik duhet të i planifikojnë aktivitete e tyre komform ndarjeve buxhetore për vitin fiskal.

Përgatitur nga:

Arta Maxhuni, Analiste e lartë e buxhetit

